

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK

13660

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 03.04.2024

V E N D I M

Nr.35, datë 28.03.2024

P Ë R

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.158, DATË 26.12.2019, TË  
KËSHILLIT BASHKIAK, "PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE  
NË QYTETIN E TIRANËS", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 113, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç", dhe pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.3, shkronja "b", nenit 34, pika 6, nenit 35, pika 4 dhe nenit 54, shkronja "f", nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 64/2012 "Për peshkimin", të ndryshuar, vendimit nr.132, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës", të ndryshuar, vendimit nr. 701, datë 18.11.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021-2025", vendimit nr. 216, datë 13.4.2023, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim", udhëzimit nr. 6, datë 11.04.2022 të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural "Për mjetet që përdoren për peshkim çlodhës-argëtues dhe mënyrën e lëshimit të autorizimit", urdhrin të përbashkët nr. 443, datë 6.10.2022 të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për përcaktimin e tarifave të autorizimit për peshkimin çlodhës-argëtues dhe tarifave për shërbimet që ofrohen nga organizata e peshkimit" dhe memo-t me nr. 45218 datë 28.12.2023 dhe nr. 4039 datë 24.01.2024 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

Në vendimin nr. 158, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 6 "Çmimi mesatar referues për përlllogaritjen e taksës", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- d. Aktivitete të ndryshme sportive mbi një ditë, 100,000 lekë/dita
  - e. Organizime të ndryshme fetare, kulturore, politike në sallën e pallatit të sportit, 120,000 lekë/dita.
  - f. Aktivitete të ndryshme të organizuara në hollin e pallatit të sportit, 30,000 lekë/dita
  - g. Salla e konferencave, 15,000 lekë/aktiviteti paradite
  - h. Salla e konferencave, 20,000 lekë/aktiviteti pasdite
  - i. Salla e konferencave për një ditë, 25,000 lekë/dita
6. Tarifat për dhënien në përdorim të fushave sportive në Parkun e Madh të Liqenit Artificial:
- a. Fusha e tenisit “Perlat Vushtina” (PMLAT):
    - tarifë për përdorimin e e fushës së tenisit 1,000 lekë/kohëzgjatja 60 min”.
  - b. Fusha e volejbollit (PMLAT):
    - tarifë për individ/grup individësh 1,400 lekë/kohëzgjatja 60 min;
    - tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 2,000 lekë/kohëzgjatja 60 min.
  - c. Fusha e basketbollit (PMLAT):
    - tarifë për individ/grup individësh 1,300 lekë/kohëzgjatja 60 min;
    - tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 2,000 lekë/kohëzgjatja 60 min.
  - d. Fusha e futbollit bar natyral (PMLAT):
    - tarifë për individ/grup individësh 2,000 lekë/kohëzgjatja 90 min;
    - tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 2,500 lekë/kohëzgjatja 90 min”.
7. Tarifat për dhënien në përdorim të Fushës Sportive të Futbollit Laprakë”:
- tarifë për individ/grup individësh 5,000 lekë/kohëzgjatja 90 min;
  - tarifë për subjekte tregtare/klube/shoqata 6,000 lekë/kohëzgjatja 90 min;

12. Në nenin 61, “Lehtësira dhe përjashtime”, bëhet ky ndryshim:

a. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përjashtohen nga detyrimi për të paguar çmimin e biletës për Trenin Panoramik tek këndi i lojrave në hyrje të liqenit, fëmijët me aftësi të kufizuara.

13. Në nenin 64 “Tarifa për kopshtet dhe çerdhet”, shkronjat “a” dhe “b”, ndryshohen si më poshtë:

“a. 170 lekë për fëmijë në kopshte”

“b. 150 lekë për fëmijë në çerdhe”

14. Në Kreun VIII “Tarifa të Institucioneve të Varësisë”, shtohen nenet si më poshtë vijon:

#### **Neni 69/1**

#### **Tarifat për Kopshtin Zoologjik**

Biletat për hyrjen në kopshtin zoologjik, janë të ndara sipas kategorive më poshtë:

- Për të rritur 300 lekë/person
- Grupmosha 3 deri në 18 vjeç 150 lekë/person
- Pensionist 150 lekë/person
- Për grup mbi 10 persona 100 lekë/person
- Persona me aftësi të kufizuara, pa pagesë